



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-12830/24 datë: 22.04.2024



Npi – 01/163 datë:22.04.2024

Bazuar në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr.28, datë 04.06.2008); Nenit 32, dhe 37 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës Nr.02/2015 të datës 28.12.2015; Si dhe në bazë të nenit 4 dhe 6 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Kryesuesi i Kuvendit vendosi të bëjë këtë:


F T E S Ë

PËR MBLEDHJEN E -V- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E cila do të mbahet në sallën e Kuvendit më: 29.05.2024 (e mërkurë) Në ora: 10:00h

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.04.2024,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (për diskutim publik)
3. Propozim-Vendim për dhënjen në shfrytëzim të pronës komunale pjesën e N.K me Nr.1404-11 ZK-Shtime me sipërfaqe 8000 m² Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit dhe Tregut SHA-KOST-it,
4. Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të N.K. Nt.1893-0 me sipërfaqe prej 341m², Z.K-Shtime,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të KK-së me numër Npi – 01/118 datë: 28.03.2024,
6. Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të KK-së me numër Npi – 01/119 datë: 28.03.2024,
7. REKOMANDIM për Kuvendin i Komisionit për ndarjen e qmimit 'Nderi Qytetit'
8. Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të akteve Npi-01/79 dhe 01/81 datë: 26.2.2024
9. Informatë e përgjithshme nga DKRS,
10. Informatë nga DBPZHR – Sektori i bujqësisë për mbjelljet pranverore,
11. Pyetje – Përgjigje.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Nr. Prot: 12/06
Datë: 22.05.2024

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Direkcija za Poljoprivredu i Ruralni Razvoj / Directorate for Agriculture and Rural Development


Për/Za/To: Sekretaria e Kuvendit të Komunës, Shtime

Përmes/Preko/Through: Drejtpërdrejt

Nga/Od/From: Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Gojart Bajrami

Lënda/Predmet/Subject: Informatë për mbjelljet pranverore



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për vitin 2024 ka planifikuar përgatitjet për mbjelljet pranverore të kulturave bujqësore dhe afati optimal për mbjelljen e shumicës së kulturave që mbillen në pranverë është 15 Prill deri me 15 Maj. Ndërsa, disa kultura perimore si: Qepa, Hudhra, Spinaqi, Sallata e gjelbërt mbillen më herët.

Në komunën e Shtimes, mbjellja e misrit dhe të lashtave tjera pranverore ka filluar dhe përfunduar me kohë, megjithëse pjesa e dytë e muajit Prill dhe fillimi i muajit Maj kanë qenë të përcjellura me të reshura të shiut dhe me temperatura të ulëta, por pas përmirësimit të motit janë krijuar kushte të favorshme për vazhdimin e mbjelljeve të kulturave pranverore.

Sipas vizitave në teren, janë vërejtur se mbirja dhe zhvillimi i bimëve është shumë i mirë.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur sipërfaqet e planifikuara dhe të realizuara për mbjelljet pranverore për secilën kulturë.

Të dhënat e sipërfaqeve të planifikuara dhe të realizuara

Nr.	KULTURAT	Sipërfaqja e planifikuara/ha	Sipërfaqet e realizuara/ha
1	Misër për kokërr	980	954
2	Misër me fasule	60	40
3	Misër i gjelbërt	400	390
4	Elb	10	0
5	Tërshërë	25	28.60
6	Bimë furagjere	20	30
7	Bimë industriale	-	-
8	Perime në serra	6	6.35

Adresa: Rr. Tahir Sinani 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës
Tel.: +383290389016, email: info.shtime@rks-gov.net
<http://kk.rks-gov.net/shtime>

9	Perime në fushë të hapur	30	17.17
10	Patate	15	11
11	Lakër	15	10.73
12	Shalqinj	5	3.46
13	Pjepër	5	4.87
14	Qepë	25	22.63
15	Kunguj	20	26.19
16	Fasule monokulturë	20	23.61
	Gjithsej:	1636	1568.61

Tregu lokal ka qenë i furnizuar mirë me agroimpute si; farëra, plehra artificiale, pesticide, fungicide, insekticide dhe herbicide.

Plehrat kimike:	Varietetet e misrit:
NPK, 15:15:15	MSA56A
URE-a	MSA48L
NAG-u	ZR 434
ZR 427	RNS 640
	RNS 444
	Pionir C9911
	Pajdash

Gjatë periudhës Janar – Maj kemi pasur tri thirrje për aplikimin e fermerëve.

1. Thirrja nga MBPZR – AZHB për aplikim të subvencioneve për kulturat e drithërave të bardha, perimeve në serra dhe fushë të hapur, pemëve drufrutore dhe pemëve të imta, blegtori, vreshtari, akuakulturë dhe bimë aromatike, mjekuese.

Në këtë thirrje kanë aplikuar 561 fermer për të gjitha kategoritë dhe aplikacionet origjinale janë dorëzuar në zyrat e AZHB-së dhe pritet ti nënshtrohen kontrollit administrativ dhe fushor nga ana e zyrtarve të AZHB-së.

Sip. Grurit	Sip. Misër	Tërrshër	Elbi	Arra	Fasule	Kunguj	Patate	Specat	
1156.83	1379.09	28.61	0.00	17.09	23.61	26.19	11.06	15.84	
Domate	Marullë	Lakër	Perime në serra	Molla	Lajthi	Dardha	Kumbulla	Manaferra	Mjedra
0.45	0.88	10.73	6.35	27.95	14.30	0.50	23.62	2.00	0.70
Dredhëza	Qepë	Shalqinj	Pjepër	Lopë qumështore	Viqa	Dele	Dhi	Pula	Bletë
0.67	22.63	3.46	4.87	371.00	38	1344	542	21500	2379

Sipërfaqja e përgjithshme e të mbjellave për këtë vit është: **2777.43 Ha**

- Thirrja e dytë është realizuar si rezultat i një marrëveshje në mes të Komunës së Shtimes dhe IADK-së në projektin *“Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit”*. Vlera e përgjithshme e projektit është: **34,690.50 Euro**, ku pjesëmarrja në projekt e komunës është me **20%** të vlerës së projektit dhe **6%** e përfituesit, ndërsa **74%** IADK.

Në këtë thirrje kanë aplikuar 84 aplikues potencial të cilët janë vizituar nga komisioni dhe janë në përfundim të publikimit të listës përfundimtare. Do të bëhet përkrahja e 9 burrave/grave në vlerë mesatare deri në 2,000.00 Euro në të mira (jo në para). Dhe përkrahja e një njësie për përpunimin e pemëve, perimeve, ëmbëlsirave apo qumështit në vlerë 3,500.00 Euro

- Thirrja e tretë, është hapur me datë 07.05.2024 për subvencionimin e fermerëve kultivues të drithërave të bardha (Misër) dhe kultivues të perimeve në serra dhe në fushë të hapur dhe është e hapur deri me datë 24.05.2024

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, e ka paraparë të ndihmoj bujqit në formën e pagesave direkte duke tentuar një shtrirje të përgjithshme. Vlera e këtij subvencionimi është **30,675.40 Euro**.

Gjithashtu, do të ketë edhe një thirrje tjetër gjatë muajit Qershor – Korrik për subvencionimin e mbarështimit të lopëve dhe vlera e këtij subvencionimi është **9,275.00 Euro**

Ndërsa, sa i përket sektorit të inspektorit të bujqësisë, po ju jap një përmbledhje të aktivitetit:

Në këtë periudhë janë bërë inspektime në të gjitha subjektet, barnatore bujqësore (kontrollimin e dokumenteve, plehrat artificiale dhe prejardhja e tyre, farërat e drithërave dhe perimeve, certifikatat fito sanitare, afatet e skadimit dhe dokumentet e konformitetit), fidanët e pemëve në treg dhe fidanët e perimeve në sera.

Në bashkëpunim me inspektorët e AVUK-ut janë bërë inspektime në bletari dhe blegtori për sëmundjet ngjitëse, gjithashtu, janë inspektuar dhe monitoruar parcelat e tokave bujqësore të mbjella me grurë për sëmundjet eventuale

Faleminderit!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/ Mayor's Office

Data/Datum/Date:	22.05.2024
Nr./Br./No:	02/ 455
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal - Shtime
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejt. Grejtali Emiri
Përmes/Preko/Through:	Kryetari të Komunës, z. Qemal Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim - Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-118 datës 28.03.2024

Propozim – Vendim për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Npi – 01/118 datë 28.03.2024, për Marrjen e të Drejtës së Shfrytëzimit të Ngastres Kadastrale Nr.2148-4 nga NPKSH “Higjiena” - Shtime

Në bazë të nenit 58, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53; Në bazë të Konfirmimit nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues Nr. 2361-2/24; të kërkesës së Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, përmes Kryetarit të Komunës së Shtimes, propozojm Kuvendit të Komunës së Shtimes ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të Kuvendit Npi – 01/118 të datës 28.03.2024 ku baza ligjore e propozuar dhe e konfirmuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues të jetë kështu:

Bazuar në Nenet 12.2 shkronja (d), 14.1, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i Vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenin 53 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008.

Arsyetim: Sipas rekomandimit të Ministris së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues ndryshohet baza ligjore për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit (Marrja e të drejtës së shfrytëzimit nuk ka të bëjë me Ligji Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ligji Nr. 03:L-205 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Bashkangjitur me kërkesë janë:

- Vendimi i Kuvendit Npi -01/118 datë 28.03.2024
- Certifikata e Pronë dhe Kopjet e Planit të Parcelës,
- Konfirmimi nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues

Adresa: Rr. Tahir Sinani, nr 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtoresh e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Npi-01/118 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të ngastrës kadastrale Nr. 2148-4 nga NPKSH "Higjena" Shtime, miratuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes, datë 28.03.2024

I nderuar kryetar Aliu,
I nderuar kryesues Ademi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimi Npi-01/118 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të ngastrës kadastrale Nr. 2148-4 nga NPKSH "Higjena" Shtime, miratuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes, datë 28.03.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshënisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave konstaton se:

Sa i përket vendimet të lartcekur, nuk është kompetencë e Ministrisë së Mjedisit, dhe Planifikimit Hapësinor të japim një konstatim sepse misioni i yni është realizimi i procesit të shpronësimit të të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi bazuar në respektimin e të drejtave ligjore.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunes së Shtinas dhe MAPL-së për çdo sqarim të mëtejshëm në lidhje me këtë vendim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7129/24 datë: 19.03.2024



Npi - 01/18 datë: 28.03.2024

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14.1, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprihim (Ligji i vjetër i Eksproprihimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Neni 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Ligji Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Nenin 53 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/207 të datës 21.03.2024, në seancën e mbajtur më 28.03.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR MARRJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË NGASTRËS KADASTRALE
Nr.2148-4 NGA NPKSH "HIGJIENA" - SHTIME**

I
Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 28.03.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë nga NPKSH "Higjiena" në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-4. Zona Kadastrale - Shtime. Me sipërfaqe prej 2000m². Kualiteti i klasës - Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Komunës - Shfrytëzues NPKSH - "Higjiena" Komuna Shtime.

II
Arsyei i: Komuna e Shtimes me vendimin Nr.01/347/2 të datës 27.09.2002 i ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm NPKSH "Higjiena" - Shtime, (tani - KRM-"Pastërtia") sipërfaqen e tokës prej 2000m² (20 ari) në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-4, në Zonën Kadastrale - Shtime, për nevoja të veta të objektit të administratës dhe autoparkut. Duke marrë për bazë Marrëveshjen Nr.02/354 të datës 27.10.2022, ndërmjet Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB) dhe Komunës së Shtimes për Bashkëfinancim dhe Realizim të Projektit "Ndërtimi i Objektivit të Komunës së Shtimes" në vlerën totale të projektit 2.5 milion euro, të cilat janë buxhetuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës, është paraqitur nevoja imediate për sigurimin e lokacionit për këtë destinim, meqenëse Komuna e Shtimes si subjekt publik nuk posedon paluajtshmëri e cila evidentohet në emër të Komunës e që i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të administratës të Komunës së Shtimes. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

III
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe ligjore për implementimin e këtij vendimi.

IV
Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb - faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V
Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit

Adnan Ademi



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Qeveria - Prada - Government

Ministria e Mbrojtjes, Planifikimit dhe Infrastrukturës / Ministristvo Zbranje, Armatije, Prostranstvo Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Emotionment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NUMËRIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-02148-4

Numri i fletës / Broj Predmet / Case Referent Number: 121/24
Data dhe koha e fletimit / Datum i vrene Predmeta / Date and time of submission: 23.01.2024 - 13:18
Komuna / Opština / Municipality: SHITINE / SHITINJE / SHITINE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shitine / Shitine / Shitine
Zyra kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: SHITINE / SHITINJE / SHITINE

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësitë kadastrale Broj kadastrske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësitë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronë Vrsta imovine Property Type	Zona URB C/S URB	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Redhja Opis Description	Krijarje ostan Izradnja Created On	Aktuar Aktiviras Updated
P-72809093-02148-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Proçë Shpërndarje / Distribucija Imovine / Sectly owned Land	Urban	2000	12.5093		13.12.2015

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvané Called place	Kodi Postajl Postanski kod Postal Code	Emri i rrugës Načrt ulice Street name	Krijarje Uradnja Created On	Aktuar Aktiviras Updated
KRYEQ				13.12.2015

A.2 LLOJI I SHPRITËZIMIT / VRSTA KORSCENIA / TYPE OF USE

Numri i Bregut / Parcel Number	Lloji i shpritëzimit të përditë / Vrsta korscenia për këtë Parcel Type Of Use	Shprehja aktuale për këtë Trembim korscenial për këtë Parcel Current Use	Klasifikimi i kësaj Kështimi / Kështimi / Class / Quantity Class	Sipërfaqja (m ²) / Surface Area (m ²)
1	Pjesëtimor / Parcel	Tëra / Total	M11 Kështimi 25mwa 2 Kështimi 2ed Class Forest	2000

B. PRONARË/POSSEDUESI - VLAŠNIK/DŔŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Titulli i Prava / Right	Emri i Proprietarit / Name	Numri i Identifikimit / ID No.	Vendbanimi / Residential	Kodi postar / Postal Code	Hollitë e adresës / Address details	Pjesë e pronës / Share/Quota	Përshkrimi / Opis / Description	Adreca / Address / Updated
Pasuri shoqërore / Shërbime publike / Single possession / Single possession	PASURI SHOQËRORE - SHËRBIME PUBLIKE / HIGHIENA	KCID2834700	SETIME / SETIME / SETIME /			1/1	17-2003	

C. NGARRESAT TËERA - OSTALI TËRETI - OTHER ENCUMBRANCES

Titulli i Prava / Right	Shënimet / Remarks	Shënimet / Remarks	Data e shpirtimit / Date	Adreca / Address / Terms and conditions	Përshkrimi / Opis / Description	Adreca / Address / Updated
Njësitë / Units / Competences / Other	Shënimet / Remarks	Shënimet / Remarks	Data e shpirtimit / Date	Adreca / Address / Terms and conditions	Përshkrimi / Opis / Description	Adreca / Address / Updated
					Parcela n.02148-4	




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shtime

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-72809093-02148-4	Parcelë / Parcele / Parcel	2000



Shkalla/Razmera/Scale: 1:415

Punoi/Obrodio/Created: Kadrije Zeqa

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____

Shënimi/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 23.01.2024

Koha/ Vreme/ Time: 01:23:53



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelaria Predsednika Opštine/ Mayor's Office

Data/Datum/Date:	22.05.2024
Nr./Br./No:	02/ 456
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal - Shtime
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtor, Grejtalb Emiri
Përmes/Preko/Through:	Kryetarit të Komunës, z. Qemajl Ajiu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim - Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-119 datës 28.03.2024

Propozim – Vendim për ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Npi – 01/119 datë 28.03.2024, për Marrjen e të Drejtës së Shfrytëzimit të Ngasrës Kadastrale Nr.2148-10 nga Kryqi Kuq i Kosovës Dega në Shtime

Në bazë të nenit 58, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53; Në bazë të Konfirmimit nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues Nr. 2360-2/24 datë 30.04.2024; të kërkesës së Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, përmes Kryetarit të Komunës së Shtimes, propozojm Kuvendit të Komunës së Shtimes ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të Kuvendit Npi – 01/119 të datës 28.03.2024 ku baza ligjore e propozuar dhe e konfirmuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues të jetë kështu:

Bazuar në Nenet 12.2 shkronja (d), 14.1, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i Vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenin 53 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008.

Arsyetim: Sipas rekomandimit të Ministris së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues ndryshohet baza ligjore për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit (Marrja e e të drejtës së shfrytëzimit nuk ka të bëjë me Ligjin Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ligji Nr. 03:L-205 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Bashkangjitur me kërkesë janë:

- Vendimi i Kuvendit Npi -01/119 datë 28.03.2024
- Certifikata e Pronës dhe Kopja e Planit të Parcelës,
- Konfirmimi nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktues

Adresa: Rr. Tahir Sinani, nr 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Qemaj Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes, Adnan Ademi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izadin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Nr. VL-68/24 Datë: 24.04.2024
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Npi-01/119 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të ngastrës kadastrale Nr. 2148-10 nga Kryqi i Kuq i Kosovës- dega Shtime, miratuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes, datë 28.03.2024

I nderuar kryetar Aliu,
I nderuar kryesues Ademi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimin Npi-01/119 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të ngastrës kadastrale Nr. 2148-10 nga Kryqi i Kuq i Kosovës- dega Shtime, miratuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes, datë 28.03.2024

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave konstaton se:

Sa i përket vendimit të lartcekur, nuk është kompetencë e Ministrisë së Mjedisit, dhe Planifikimit Hapësinor të japin një konstatim sepse mision i yri është realizimi i procesit të shpronësimit të të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi bazuar në respektimin e të drejtave ligjore.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunitetit të Shtimit dhe MAPI-së për çdo sqarim të nevojshëm në lidhje me këtë vendim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7129/24 datë: 19.03.2024



Npi - 01/119 datë: 28.03.2024

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14.1. dhe neni 17 shkronja (e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Ekspropriimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Neni 4 i Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Ligji Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Nenin 53 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/207 të datës 21.03.2024, në seancën e mbajtur më 28.03.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR MARRJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË NGASTRËS KADASTRALE
Nr.2148-10 NGA KRYQI I KUQ I KOSOVËS – DEGA NË SHTIME**

I
Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 28.03.2024, me shumicën e votave, miratoi Vendimin për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë nga Kryqi i Kuq i Kosovës – Dega në Shtime, në Ngastër Kadastrale me numër P-72809093-02148-10, Zona Kadastrale – Shtime. Me sipërfaqe prej 1000m². Kualiteti i klasës – Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit të Komunës Shtime – Shfrytëzues Kryqi i Kuq i Kosovës, Dega në Shtime.

II
Arsye i m: Komuna e Shtimes me vendimin Nr.01/6/3867 të datës 25.11.2005 i ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm Kryqit të Kuq të Kosovës – Dega në Shtime, sipërfaqen e tokës prej 1000m² (10 ari) në Ngastër Kadastrale me numër P-72809093-02148-10, në Zonën Kadastrale – Shtime, për nevoja të veta të objektit të administratës, por që nuk është ndërtuar deri më tani. Duke marrë për bazë Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB) dhe Komunës së Shtimes për Bashkëfinancim dhe Realizim të Projektit "Ndërtimi i Objektit të Komunës së Shtimes" Nr.02/354 të datës 27.10.2022, në vlerën totale të projektit 2.5 milion euro, të cilat janë buxhetuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës, është paraqitur nevoja imediate për sigurimin e lokacionit për këtë destinim, meqenëse Komuna e Shtimes si subjekt publik nuk posedon paluajtshmëri e cila evidentohet në emër të Komunës e që i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të administratës të Komunës së Shtimes. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

III
Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe Ligjore për implementimin e këtij vendimi.

IV
Ky Vendim lyp në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V
Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit

Adnan Ademi

[Signature]



Republika e Kosovës
 Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Mbrojtjes, Planifikimit dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Zbranje, Prostorneq Planifikimja i Infrastruktura /
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-02148-10

Numri i fletës / Broj Predmet / Case Referent Number: 12124
Data dhe koha e krahut / Datum i prijme krahvanja / Date and time of submission: 23.01.2024 - 13:19
Komuna / Opština / Municipality: SHITINE / SHITINE / SHITINE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: SHITINE / SHITINE / SHITINE
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: SHITINE / SHITINE / SHITINE

A. TË BIDENAT PËR NËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i fletës kadastrale Broj Katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësitit Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona Zona GIS GNK	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Periçketa Opis Description	Krijarje e drita Udružena dita Created On	Aktuarizim Aktualizirano Updated
P-72809093-02148-10	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë s'pjegjose / Društvena / Imovine / Socially owned Land	Urban	1000		11.12.2015	

A.1 ADRESA E NËSINË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qaqshor Mesto i zano Cadastral place	Kodi Postel Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijarje e drita Created On	Aktuarizim Aktualizirano Updated
ERYQ				11.12.2015

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISÇENIA / TYPE OF USE

Nr. Bregje Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shtreshtet aktualisht të përdorura Terenet korisçenja të përdorura Parcel Current Use	Kualiteti i kartës Kualiteti i Kartës Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Përshirja (m ²)
1	Djeshmëri/Foresty	Tokat Dije/Arboret zone të përdorura	Mu i Kartës 2/Sema 2 Kiber/2nd CUR Forest	1000

B. PRONAR/POSËDUESI - VLASNIK/DRËZALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri i Ismi Name	Nr. personal Identifikues ID No.	Vendbanimi Prahbanje Resident	Koordinatat Pozicioni i tokës Parcel code	Hodotimi dhe adresi Populimi dhe adresi Address details	Pisa e pronës Drejtuesit Share quota	Përshkrimi Opis Description	Aktuar Aktuar Updated
Prava e drejtuarit / Institucionale Drzavina / Shtete pasqer	P. S.H.E.K.K.SHTIME SHFRYTËZUES KRYQI KVOI KOSOVES PASURI		SHTIME / SHTIME / SHTIME /			1/1		




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOP-JA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komune/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHITIME
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shime

Nr./No./Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-72509093-02148-10	Parcelë / Parcela / Parcel	1000



Shkalla/Razmera/Scale: 1:325

Punci/Obradio/Created: Kad-ije Zeqa

Nënskrimi/Potpis/Signature: _____

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 23.01.2024

Koha/ Vreme/ Time: 01:24:51



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Preedsdnika Opštine/ Mayor's Office

Data/Datum/Date:	22.05.2024
Nr./Br./No:	02/454
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal - Shtime
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtor, Grejtalb Emini
Përmes/Preko/Through:	Kryetarit të Komunës, z. Qemaj Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim - Vendim për shpallje të pronës së paluajtshme me interes të përgjithshëm

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 neni 13, dhe Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53, në bazë të Ligjit nr 03/L – 139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neni 4 pika 1 dhe 2, me ndryshimin dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205; me rastin e hapje-zyrtarizim të rrugës "Mic Sokoli", e cila lidhë rrugën "Skender Salihaj" me rrugën kryesore "Komandant Kumanova, propozoj shpalljen e pronës së paluajtshme me interes të përgjithshëm për ngastrën kadastrale me P-72809093-01893-0 me sip.341m², Z.K. Shtime.

Arsyetim: Zgjerimi i rrugës " Mic Sokoli" dhe krijimi i rrethrotullimit që bashkon rrugët: "Komandant Kumanova" rrugën "Mic Sokoli" dhe rrugën "Skender Salihaj"

Bashkangjitur me kërkesë janë:

- Certifikata mbi pronën dhe Kopja e Planit të Parcelës



Republika e Kosovës
 Republica Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ëmështet, Planifikimit Hapësinor dhe Infrazhëritës / Ministarstvo Zhovne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrazhëritance /
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NUJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-01893-0


Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Reference Number: 682/24
 Data dhe koha e tëshmit / Datum i vrene Izdavanja / Date and time of submission: 21.05.2024 - 09:19
 Komuna / Opština / Municipality: SHITIME / ŠTITILJE / SHITIME
 Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shitme / Šitnje / Shitme
 Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office: SHITIME / ŠTITILJE / SHITIME

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj kadastrske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësise Vida jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta inovine Property Type	Zona VR CS UR	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përkrahje Opis. Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72809093-01893-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Privata / private / Privately owned Land	Urban	324			


A.I ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qajfur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Kartë rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SHITIME				



A.2 LLOJII I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Droi Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesës Trenulho koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kualitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Tokë Ndërtimore/Grajdjevinshko zemljište/Construction land	Obor/Dvorëshe/Back Yard		233
2	Tokë Ndërtimore/Grajdjevinshko zemljište/Construction land	Shtëpi: Ndërtesë/Kuca: Zgjedhje/House: Building		91



B. PRONARË/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtuesi Prava Rtgajs	Emri Ime Name	Nr. personal Licenç broji ID. No.	Vendbanimi Prebivaljište Resident	Kodi postar Potanski kod Postal code	Hullësitë e adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazavina / Single possessor	NUHA FADIL (SHEFKI)	1013879512	SHTIME / ŠTIMALJE / SHTIME /		7	1/1	Kontratë mbli dhuruar e pamundshuarisë Zyra Noletrale Štimate	12.05.2015




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY
 KOPJA E PLANIT / KOPJA PLANA / COPY PLAN


Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME
 Zona Kadastrale/ Katastarska Zona / Cadastria Zone: Shtime

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-72909093-01893-0	Parcelë / Parcela / Parcel	324



Shkalla/Razmera/Scale: 1:175

Punoi/Obradio/Created: Kadrije Zeqa
 Nënshkrimi/Potpis/Signature:
 Shënim/Beteška/Note:



Data/ Data/Date: 21.05.2024
 Koha/ Vreme/ Time: 09:21:15



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/ Mayor's Office

Data/Datum/Date:	22.05.2024
Nr./Br./No:	02/ 453
Për/Za/To:	Kuvendi Komuna! - Shtime
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtor, Grejtalb Emini
Përmes/Preko/Through:	Kryetari të Komunës, z. <i>Alin</i>
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim – Vendim për dhenjen në shfrytëzim të pronës komunale Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit dhe Tregut SH.A KOSTT-it

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 neni 13, dhe Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53; Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 21 pika 1.1 dhe pika 2: si dhe në bazë të kërkesës së palës në këtë rast KOSTT SH.A e përfaqësuar nga Alban Imcri Departamenti për Zhvillimin e Rrjetit dhe Projekteve, Nr 1006 datë 25.04.2024, me rastin e ndërtimit të nënstationit NS 110/35/10 (20) KV Shtimja, propozoj dhenjen në shfrytëzim të pronës komunale Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit dhe Tregut SH.A KOSTT-it pjesën e ngastrën kadastrale me P-72809093-01404-11 me sip 8000 m², Z.K. Shtimë.

Arsyetim: Kërkesa e palës ka të bëjë me realizimin e e projektit madhor me rëndësi të madhe për komunën e Shtimes, ku kërkojnë sigurimin e lokacionit në hapsirën prej 8000 m², (80 ari), për ndërtimin e nënstationit NS 110/35/10 (20) KV, dhe sigurimine trasesë (koridoreve) për ndërtimin e linjave 110 KV për furnizimin e nënstationit.

Bashkangjitur me kërkesë janë:

- Kërkesa e KOSTT-it Nr.1006 datë 25.04.2024,
- Certifikata mbi pronën dhe Kopja e Planit të Parciës

Adresa: Rr. Tahir Sinani, nr.50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>



Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-01404-11

Numri i lëndës / Broj Pretmet / Case Referent Number: 697/24

Data dhe koha e kërimit / Datum i vremen izdavanja / Date and time of submission: 22.05.2024 - 11:22

Komuna / Opština / Municipality: SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME

Zona kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastral Zone: Shtime / Štimlja / Shtime

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale / Broj katastrarske jedinice / Cad. Unit. No.	Lloji i njësive / Vrsta Jedinice / Unit Type	Lloji i pronës / Vrsta imovine / Property Type	Zona / U/R / GIS / U/R	Sipërfaqja / Përfaqja / Površina / Area (m ²)	Përshkrim / Opis / Description	Krijtar më datën / Uradjeno na dan / Created On	Azhuruar / Azurirano / Updated
P-72809093-01404-11	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena / Socially owned Land	Urban	143306		02.12.2019	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur / Mesto zvano / Called place	Kodi Postar / Postanski Kod / Postal Code	Emri i rrugës / Naziv ulice / Street name	Krijtar më datën / Uradjeno na dan / Created On	Azhuruar / Azurirano / Updated
GËSHTENJA			02.12.2019	

A.2 LLOJII SHERYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Bujqësore/Poljoprivredna/Agriculture	Kullosaj/Pashujaci/pasture	Kullosë E Klasës 4/Pashujak 4 Klase/4th Class Pasture	143306

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID, No.	Vendbanimi Prehivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual/ Individualna Drazavna / Single possessor	Komuna e Shtimes	600258976	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME /		TAHIR SINANI	1/1		05.12.2019



Kuvendi Komunal
Shtimje
Drejtoriait të Drejtoriatit për Urbanizëm dhe Gjeodezi

24.04.2024

**Lënda: Kërkesë për sigurimin e lokacionit për ndërtimin e nënstacionit
NS 110/10(20) kV Shtimje si dhe trasenë për linjat përcjellëse 110kV**

Të nderuar,

Bazuar në Planin Zhvillimor 2024-2033, të Sistemit Transmetues të Kosovës si dhe duke parë nevojat e plotësimit të konsumit me energji elektrike për rajonin e Shtimjes, është planifikuar ndërtimi i nënstacionit të ri NS 110/35/10(20) kV - Shtimje me linjat përcjellëse 110kV.

Për realizimi e këtij projekti madhor dhe me rëndësi të madhe për komunë tuaj, ju drejtohem me kërkesë për shqyrtimin e mundësive për sigurimin e lokacionit në hapësirë prej 80 x 100 m = 8000m² (80 ari) për ndërtimin e nënstacionit NS 110/35/10(20) kV Shtimje dhe sigurimin e trasës (korridoreve) për ndërtimin e linjave 110kV për furnizimin e nënstacionit. Jemi në dijeni se sipas ligjit komunat duhet të parashohin projektet në planin Zhvillimor të Komunës, në Planin hapësinorë si dhe në hartat zonale, prandaj shpresojmë se kërkesën për projektin e ri do ta shqyrtoni dhe do ta planifikoni në planet e juaj.

Ju informojmë se në kuadër të realizimit të projektit parashiher :

- Ndërtimi i NS 110/35/10(20) kV Shtimje me një Transformator të fuqisë 40MVA; një(1) fushë transformatorike 110kV, dy(2) fusha të linjës/kabllore ,një (1) fushë lidhëse 110kV me komplet pajisjet e tensionit të lartë dhe atij të mesëm;
- Kablo dyfishe 1.7km, 1000 mm², nga nënstacioni deri te lidhja në linjën ekzistuese 110 kV NS Theranda-NS Kastriot

Si shtojcë po ju përcjellim dokumentet ku shihet vendi i propozuar për nënstacion dhe trasenë e propozuar për linja/kabllon .

Mbesim me shpresë për përkrahje dhe shqyrtim sa më të shpejtë të kërkesës sonë.


Sinqerisht,

Alban Imeri, drejtor


Departamenti për Zhvillimin e Rrejetit dhe Projekteve, KOSTT



SHTIME
SKICA E NDARJES



SKYLINE
SKICA ENDRJES



1304-11

1404-3

1304-11

1304-11

1304-11

1304-11


1304-11

1304-11

1304-11

1304-11

1304-11





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit

Data/Datum/Date:	15. 5. 2024
Nr./Br./No	Nr. 02/436
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	z. Qemajl Aliu, kryetar i komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Zyra për Komunikim me Publikun, Vjora Hyseni
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim-Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e akteve: Npi-01/81 dhe Npi-01/79

Duke u bazuar në kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) nr. 020-183, datë 13. 3. 2023 për rishqyrtim të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale dhe kërkesës nr. 0-185, datë 13. 3. 2024 për rishqyrtim të Rregullores Komunale për Transparencë, kërkojmë që të Planit i Veprimit për Transparencë Komunale 2024-2028, Npi-01/81, datë: 26. 2. 2024 të bëhet ky plotësim-ndryshim të pjesa e kornizës ligjore, gjegjësisht të pjesa hyrëse të largohet: Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2008 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, të mbetet vetëm Udhëzimi Administrativ MAPL Nr.04/2003 për Administratë të Hapur në Komuna dhe të përfshihet Rregullorja nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve Komunale, e jo Nr. 01/2017.

Ndërkaq, të Rregullores Komunale për Transparencë, Npi-01/79, datë 26. 2. 2024 të bëhet ky plotësim-ndryshim të pjesa e kornizës ligjore, gjegjësisht të pjesa hyrëse të largohet: Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2008 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, të inkorporohet vetëm Udhëzimi Administrativ MAPL Nr.04/2003 për Administratë të Hapur në Komuna dhe të përfshihet Rregullorja nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve Komunale, e jo Nr. 01/2017.

Po ashtu të pragrafi 27.4 e nenit 27 të Rregullorja Komunale për Transparencë, ku ceket: "Nëse organet komunal nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi ka të drejtë ta ushtrojë kërkesën konfirmuese. Në rast se kërkesa konfirmuese refuzohet plotësisht apo pjesërisht, organi komunal kompetent e njofton parashtruesin me mjete ligjore që i ka në dispozicion ai/ajo (nisja e procedurës gjyqësore ose parashtrimin e ankesës Avokatit të Popullit)", duhet të jetë:

Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes apo mos përgjigjes së institucionit publik, kërkuesi mund t'i drejtohet me ankesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komisioni për ndarjen e Çmimit "Nderi Qytetit"
Nr.01-060/01-12922/24 datë: 22.05.2024



Npi - 01/167 datë: 23.05.2024

Bazuar në Nenet 12.2 shkronja (d), si dhe Nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenin 5 dhe Nenin 10, pika 2, të Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, Npi - 01/173, të datës 27.5.2009, si dhe duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes për formimin e Komisionit për ndarjen e çmimit "Nderi Qytetit" Npi-01/76 të datës 26.02.2024, Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 23.05.2024, miratoi këtë:

REKOMANDIM

PËR KUVENDIN E KOMUNËS - SHITIME PËR NDARJEN E ÇMIMIT "NDERI QYTETIT"

I

Komisioni për ndarjen e Çmimit "Nderi Qytetit", në mbledhjen e mbajtur më 23.05.2024, unanimisht i Rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratojë vendimin për ndarjen e çmimit "Nderi Qytetit", të Komunës së Shtimes, për grupin e Plejadës së Mjekëve të Suksesshëm, që avansuan shëndetësinë e Komunës së Shtimes në rrafshin Kombëtar dhe Ndërkombëtar, si vijon:

1. z.Rifat Bajrami - Carralevë,
2. z.Hysni Arifi - Belinc,
3. z.Sami Salihu - Mollopolc,
4. z.Isa Haxhiu - Rashincë,
5. z.Vezir Bajrami - Reçak, (Post mortum)

II

A r s y e t i m: Komisioni për ndarjen e Çmimit "Nderi Qytetit", duke u bazuar në kompetencat e veta në bazë të korrnizës ligjore të përshkruar më lartë, dhe pas diskutimeve lidhur me historikun e personaliteteve të Plejadës së Mjekëve të Suksesshëm për Komunën e Shtimes, Komisioni ka miratuar Rekomandimin për Kuvendin që t'u ndahet çmimi "Nderi i Qytetit" të Komunës së Shtimes. Për anëtarët e komisionit të gjithë këta kanë qenë dhe janë, personalitete të spikatura të njohur si Profesor, Menaxherë Klinikash, Kontribues në fushën e shkencës së mjekësisë, të cilët kanë kontribuar mjaft shumë në veçanti për shëndetësinë e Komunës së Shtimes, e në përgjithësi, në rrafshin kombëtar si në edukimin e brezit të ri të mjekëve, po ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar me punime shkencore e studimore në fushën e shëndetësisë.

III

Rekomandimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të Komisionit, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, dhe Zyrës për Informim.




Kryesuesi i Komisionit
Faruk Beqa



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Data/Datum/Date:	23.5.2024
Nr.Br.No:	09/61
Për/ Za/To:	Kuvendi i Komunës-Shtime
Nga/Od/From:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Drejtoresha, Albana Fazliu
Lënda/ Predmet/Subject:	Informatë



Të nderuar,

Gjatë periudhës Janar-Maj në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë zhvilluar shumë aktivitete të cilat janë të elaboruara në vijim.

15 JANARI 2024 – “DITËT PËRKUJTIMORE TË MASAKRËS SË REÇAKUT”

Në këtë vit, për nder të 15 Janarit, janë organizuar "Ditët Përkujtimore të Masakrës së Reçakut". Aktivitetet janë mbajtur nën patronatën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës Sh.T.Z Albin Kurti, në përkujtim dhe nderim të kësaj dite, duke filluar nga data 13 janar.

13.1.2024

- Është shfaqur shfaqja teatrale "Shkamat" me regji të profesor Fadil Hysaj
- Është mbajtur koncert me këngë korale nga AKV "Ilirida"

14.1.2024

- Në përkujtim të kësaj dite është mbajtur një aktivitet nga SHBA "Guri i Shtrenjtë"- Eeja tradicionale për nder të 25 Vjetorit të Masakrës së Reçakut
- Është mbajtur Ora e Madhe Letrare

15.1.2024

- Në Kompleksin Memorial në Reçak u bënë homazhe nga krerët e shtetit dhe nga qytetarë të shumtë, nga e gjithë Kosova.
- Është mbajtur Orë Përkujtimore kushtuar 25-Vjetorit të Masakrës së Reçakut. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin përfaqësues të Institucioneve qendrore lokale si dhe ish ambasadori amerikan z. William Walker.

19 JANAR 2024 –

Nën patronatën e Kryetarit të Komunës, z. Qemajl Aliu së bashku me shoqatat e dalura nga lufta e UÇK-së është mbajtur manifestimi përkujtimor me rastin e 25 vjetorit të rënies së Heroit të Kombit, Ahmet Kaçiku dhe dëshmorëve të lirisë, të rënë në Reçak, më 15 janar 1999.

- Janë bërë homazhe në Varreza e Dëshmorëve si dhe te varri i heroit të kombit Ahmet Kaçiku.
- Në Shtëpinë e Kulturës, në Shtime, u mbajt edhe një Akademi përkujtimore për t'i nderuar të rënë për liri.

26 JANAR 2024 – është shpallur konkursi për aplikim për sportistët më të dalluar të vitit 2023.

13 dhe 14 SHKURT 2024

- Është realizuar shfaqja teatrale për fëmijë "Super Air" me regji të Behar Ibishit dhe të shkruar nga Ergjan Mehmeti

14 SHKURT 2024

- Për nderë të 15 Shkurtit – Ditës së Flamurit të Komunitetit Ashkali, Këshilli Organizativ i komunitetit ashkali në bashkëpunim me Komunën e Shtimes, ka organizuar program kulturor-artistik, i cili është përkrahur nga DKRS.

17 SHKURTI 2023 – 16 VJETORI I PAVARËSISË SË KOSOVËS

Përvjetori i Pavarësisë së Kosovës është shënuar me aktivitete të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me klubet sportive, OJQ lokale dhe shkollat.

Më 16.2.2024

- Është mbajtur program kulturo-artistik nga nxënësit e shkollës së mesme, Institucioni i Arsimit dhe Aftësimin Profesional (në Shkollën Profesionale)
- Është zhvilluar ndeshja miqësore në volejboll nga KVF"Vjosa" dhe KVF"Malisheva" (në Palestrën e Sporteve në Shtime);

17.2.2024

- Është mbajtur Seanca Solemne e Kuvendit të Komunës së Shtimes;
- Janë bërë homazhe të shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Shtime, Carralevë, Rancë, Reçak dhe Mollopoc;
- Inagurimi i Kullës, në Mollopoc;
- Është mbajtur Ceremonia e zgjedhjes së sportistëve të vitit 2023 (në Shtëpinë e Kulturës);
- Shfaqja e baletit nga shkolla e baletit "Let's Dance" nga Prishtina;
- Programi kulturo-artistik nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Ilirida" (në Shtëpinë e Kulturës).

5.3.2024

- Është mbajtur shfaqja për fëmijë "KËSULKUQJA", me regji të Sabri Pajazitit.

ËSHTË SHËNUAR 26-VJETORI I EPOPESË SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

5 MARS 2024 –

- Është mbajtur mbledhje solemne e Kuvendit të Komunës së Shtimes, kushtuar Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

6 MARS 2024

- Në shenjë nderimi për luftën dhe sacrificën për liri, gjatë ditës delagacioni nga Komuna, ka bërë homazhe edhe në Kompleksin Momerial "Adem Jashari", në Prekaz
- Janë bërë homazhe pranë shtatores së Komondantit Legjendar Adem Jashari, në qendër të Shtimes, pastaj te Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së, në Shtime, në Kompleksin Memorial në Reçak dhe te Varrezat e Dëshmorëve në Mollopoc.

7 MARS 2024

- Është realizuar shfaqja, "LIBRI MAGJIK", me autor Dashuri Rexhepi.

8 PRILL 2024

- Është shënuar dita e komunitetit Rom, aktivitetet janë përkrahur nga DKRS.

10 MARS 2024

- Është mbajtur turniri tradicional i shahut për nder të Epopesë së UÇK-së

12 PRILL 2024

- Në Shtëpinë e Kulturës, në Shtime, është promovuar libri "Idriz Daut Rexhepi dhe bashkëveprimtarët e tij", nga autori Halil Halili.

20 PRILL 2024

- Është zhvilluar gara tradicionale e peshkimit me tapë, e organizuar nga Shoqata "Salmoni" në kategoritë e seniorëve, juniorëve, pionerëve dhe vajzave.

23 PRILL 2024

- Është shënuar me aktivitete të ndryshme Dita Botërore e Librit, me vizita në shkolla, biblioteka dhe bashkëbisedim me nxënësit rreth kësaj dite.

25 PRILL 2024

- Është mbajtur turniri në Volejboll me nxënëset (femra) e Shkollave të Mesme të Ulëta dhe Shkollave të Mesme të Larta, në kuadër të projektit: "Masovizimi i volejbollit tek femrat e Komunës së Shtimes", përkrahur nga DKRS, M4Y dhe MAPL.

7 MAJ 2024

- Është shfaqur Premiera e Dramës "Enea i Plagosur", me regji të Iliriana Arifit.

10 Maj 2024

- Në Shtëpinë e Kulturës është promovuar libri "Meloditë e Zembrës" nga Aurela Dugolli.

Më datë 23.5.2024, do të shfaqet premiera e shfaqjes "Çka je ti", nga Klubi teatral i Shtimes dhe "Art Polis", me mbështetje të Frieda dhe Komunës së Shtimes.

Më datë 30.5.2024, do të shfaqet premiera e shfaqjes "Pacienti i doktor Frojdit".

Sport

Të gjitha klubet sportive kanë përfunduar garat e sezonit pranveror dhe kanë arritur rezultate të kënaqshme: Klubi i Futbollit "Vjosa" garon në Ligë e Parë "B" të Futbollit në Republikën e Kosovës dhe janë në vendin e tretë në tabelë, me grupmoshat e fatosëve janë kampion në grupin "A" të regjionit të Ferizajit dhe me grupmoshat e Kadetëve Kampion, në regjionin e Ferizajit. Klubi i Futsallit "Vjosa" garon në Superligën e Kosovës në Futsall, kanë përfunduar garat e sezonit pranveror dhe janë në vendin e katërt në tabelë. Klubi i Hendbollit "Vjosa" femrat – kanë përfunduar garat në sezonin pranveror dhe radhiten në vendin e dytë në ligën e parë të hendbollit të Kosovës, ndërsa vazhdojnë garat me grupmoshat e pioniereve. Klubi i Hendbollit "Vjosa" meshkujt - kanë përfunduar garat në sezonin pranveror dhe tani kanë kaluar në Superligën e Kosovës në Hendboll. Klubi i Volejbollit "Vjosa" femrat – nuk i kanë zhvilluar garat në sezonin pranveror në ligën e parë të volejbollit të Kosovës, garat do t'i vazhdojnë në sezonin vjeshtor. Klubi i Volejbollit "Vjosa" meshkujt – kanë përfunduar garat në sezonin pranveror në ligën e parë të volejbollit të Kosovës dhe radhiten në vendin e katërt në tabelë. Klubi i Veteranëve të Futbollit "Vjosa" – kanë përfunduar garat në Ligën e Veteranëve në Futboll. Klubi i Çiklizmit "Vjosa" – klubi i Çiklizmit „Vjosa” nga Shtimja (nikoqirë i garës), në bashkëpunim me Federatën e Çiklizmit të Kosovës kanë organizuar garën çiklistike rrugore "Road Race In Memoriam "Nusret Mslu", të dytë me radhë të kalendarit të garave për edicionin garues 2024 Klubi i Motocrossit "Vjosa" – ka realizuar garën në kuadër të Federatës të Motocrossit në Kosovës, ku pjesmarrës kanë qenë 45 garues nga e gjithë Kosova dhe nga Maqedonia e Veriut. Klubi i Kik-Boksit "Skender Salihaj" – kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të kalendarit të Fedartës së Kik-Boksit të Kosovës, kanë marr pjesë në kampionatin botëror në Turqi, ku kikboksieret e tanë e kanë përfaqësuar Kosovën në këtë kampionat.

Klubi i Boksit "Skender Salihaj"- kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të kalendarit të Federatës së Boksit të Kosovës, kanë marrë pjesë në turne të ndryshëm në Kosovë.
Klubi i Karatesë "Vjosa"- kanë zhvilluar garat në kuadër të Federatës së Karates të Kosovës.
SHBA "Guri i Shtrejtë" -ka zhvilluar disa aktivitete të bjeskatarisë, ecje me rastin e datave me rëndësi në komunën e Shtimes.
SHBA "Vjosa"- kan realizuar disa aktivitete të bjeskatarisë gjatë kësaj periudhe.

SUBVENCIONET

Drerjtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë kësaj periudhe, ka bërë dy thirrje publike për përkrahje financiare për OJQ-të rinore, kulturore dhe klubet sportive.
Thirrja për sport ka vlerën prej 61,000.00€ dhe ka përfunduar, kanë përfituar 15 klube sportive dhe shoqata sportive-rekreative.
Thirrja për Kulturë dhe për Rini ka vlerën prej 23,000.00€ dhe është e hapur nga data 17.5.2024 deri më 6.6.2024.

MUZEU I QYTETIT

Gjatë periudhës Janar- Maj, Muzeun e Qytetit e kanë vizituar (319) vizitorë ku (166) prej tyre kanë qenë meshkuj dhe (153) prej tyre femra, po ashtu në mënyrë të organizuar kanë vizituar muzeun, gazetarë, studentë të historisë, nxënës të shkollave, të cilët kanë parë për së afërmi reliktet dhe eksponatet që janë në muze dhe kanë mësuar për historinë dhe vlerat e muzeut, pastaj ka pasur vizita edhe nga OJQ-ët dhe televizionet e ndryshme, institucionet etj.

BIBLIOTEKA E QYTETIT

Në Bibliotekën e qytetit vazhdimisht po rritet numri i lexuesve dhe fondi i librave, numri total i lexuesve gjatë periudhës Janar-Maj është 640, lexues aktivë 250, lexues të rinj janë 22, libra të lexuara janë 400, libra të dhuruara gjithsej janë 15 nga qytetarët e Shtimes dhe libra jasht përdorimit janë 6. Biblioteka jonë posedon një numër të madh të librave të fushave të ndryshme për studim po ashtu edhe vetëm për lexim në kohën e lirë.

INVESTIMET KAPITALE

Projektet kapitale që janë të planifikuara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2024 e që kanë përfunduar me procedurat e prokurimit dhe që janë lidhur kontratat, dhe priten të fillojnë punimet shumë shpejt sipas planit të menaxhimit janë:
Projekti për Zërimin dhe Ndriçimin Profesional në Shtëpinë e Kulturës-projek në vlerë prej 24,292.00 €, ka përfunduar sipas planifikimit.
Projekti, Ndërtimi i fushës sportive në fshatin Zborc, projekt dyvjeçar, i cili ka vlerën 39,444.74€ dhe përfundon në muajin gusht të këtij viti.
Projekti Rrethojat e fushave sportive në fshatin Carralevë, Petrovë dhe Davidoc, ky projekt është dyvjeçar dhe përfundon në këtë vit dhe ka vlerën totale 59,168.63€
Projekti Renovimi i Shtëpisë së Kulturës, është në procedurë të hartimit të projektit nga kompania projektuese.
Projekti Konservimi i Eksponatave të Muzeut të Qytetit, gjithashtu është në procedurë të hartimit nga kompania projektuese.


PROJEKTET PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME, disa janë ende në procedurë të prokurimit dhe disa kanë përfunduar dhe janë lidhur kontratat si:

Furnizimi me buqeta luqesh, e cila ka vleren prej 1,430.00€
Furnizim i zyres nga DKRS, kemi vlerën prej 769.51€
Furnizimi me material higjienik nga DKRS, kemi vleren prej 1.130.80€
Furnizimi me llaptop dhe kompjuter nga DKRS, kemi vlerën 540.00€
Koktej me rastin e festave nga DKRS, kemi vlerën 840.00€
Projekti për manifestimin e Festave Shtetërore dhe Komunale, ka vlerën 16,640.00€

PROJEKTET E PËRKRAHURA NGA MINISTRIA E KULTURËS , RINISË DHE SPORTIT
Projekti me bari sintetik në stadiumin e qytetit ka përfunduar, ky projekt është realizuar nga Federata e Futbollit të Kosovës dhe Komuna Shtimes.
Projekti, Punët ndërtimore për zbatimin e hollësishtëm të arkitekturës dhe inxhinierisë për zgjerimin dhe renovimin e Stadiumit të Qytetit, ky projekt është dyvjeçar dhe ka filluar të realizohet dhe ka vlerën 2,424,242.42€.
Projektet, Renovimi i Palestrës së Qytetit, Invertarizimi i Bibliotekës së Qytetit dhe Restaurimi dhe Renovimi i Shtëpisë së Përshpirtshme janë në fazën e tenderimit në MKRS.

Me respekt,
Abana Fazliu-Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport

SHTIME SKICA E NDAJES



1404-11

Stacioni

Stacioni NSI 1005 HD (20) IVI

S=2000 m²

1404-12

1404-13 1404-14 S=2000 m²

